



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:050381  
Datë: 21.03.2019  
Numri i dokumentit: 00253469

P.nr.14/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh. J. S. nga Ferizaj ,asgjësimi apo demtimi i pasurisë nga neni 333, paragrafi 1 i KS-së, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.3166-7/17 të dt. 15.01.2018, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt. 20.03.2019, në prezencë të PSH Milot Krasniqi, të dëmtuarit si dhe të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli ,ndërsa me daten 21.03.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Xh. S., nga i ati J., e ëma S., e lindur H., i lindur me dt.04.03.1987, jeton në Ferizaj, me banim në rrugën “B. e K.”nr .. Ferizaj, i martuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPP-së.

**REFUZOHET AKUZA**

Se me date 10.11.2017 rreth ores 06:17 minuta, në rrugën D.-Suharekë, saktësisht në pompën e derivative “ I. P.”, ia dëmton dhe e bënë të paperdorshem pasurin e të demtuarit M. H., në atë mënyrë që i pandehuri, me kamionin e tij të markes “ S.” me targa të regjistrimit 6..-Ks-2..., ndalon në pompën e derivative me qellim që të furnizohet me naftë, dhe deri sa ishte duke u furnizuar ende pa përfunduar procesin e furnizimit ka filluar të lëviz me kamionin e tij pa hequr gypin (pistonin) e pompës, ku rrëzon distributorin ( pompën e furnizimit me naft ) në tokë, me qrast të demtuarit i shkakton dëm material.

Me çka kishte për të kryer veprën penale asgjësimi apo demtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KP-së.

- Për shkak se PSH në shqyrtim gjyqësor është tërhequr nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.

I dëmtuari M. H. udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore per demin udhëzohet në kontekst civil.

## Arsyetim

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr.3166-7/17 të dt. 15.01.2018, ka akuzuar Xh. S. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale asgjësimi apo demtimi i pasuris nga neni 333, paragrafi 1 i të KP.

I dëmtuari M. H. në seancë ka deklaruar se dëmin do ta kërkoj ne procedure civile.

PSH Milot Krasniqi në seancë në fjalën perfundimtare ka deklaruar duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit M. H. i cili deklaroj se deri tek demtimi i pompës së derivateve ka ardhur si rrjedhojë e pa kujdesis së kryerit e poashtu edhe vete punëtorit që ka qene ate dite ne ndërrim . Nga dëshmitari Sh. L. i cili e ka përshkruar në tërësi ngjarjen rezulton se me veprimet e të akuzuarit Xh. S. kemi të bëjmë me pakujdesi e poashtu kjo pakujdesi ekziston edhe vete puntoret e pompës I. P. të cilët ne rrethana normale do të duhet të ishin me te kujdesshëm per te evituar aksidente të tilla. Edhe nga mbrojtja e dhene nga vete i akuzuari Xh. S. i vërtetua se i njëjti është furnizuar edhe me parë në kete pompë te derivateve dhe duke analizuar të gjitha rrethanat e këtij rasti nuk ka asnjë dileme se deri tek aksidenti ka ardhur si rrjedhojë e pakujdesisë se te dy palëve per qka e përjashtoj qëllimin e te akuzuarit per ti shkaktuar ndonjë dem këtu te dëmtuarit. Bazuar në këtë gjendje faktike duke pas parasyshë faktin se kjo vepër penale kërkon qe vepra te jete kryer me qellim e qe ne rastin konkret kemi te bëjmë vetëm me pakujdesi PSH tërhiqet nga ndjekja e me tejme penale ndaj të akuzuarit Xh. S. per veprën penale asgjësimi apo demtimi i pasuris nga neni 333 paragrafi 1 i KP-së, i bindur se ne kete rast kemi te bëjmë me nje raport juridiko civil per qka këtu i akuzuari mund te kete përgjegjësi per demin e shkaktuar por jo edhe pergjegjsi penale.

Pasi që PSH në Prizren është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit Xh. S., gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPP, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par.1 të KPP.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**

**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr. 14/18 të dt.21.03.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e paranimimit të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.